



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Department of Freelance Professions
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.02/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.135/22, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija-Kerveshi, pala ankuese dhe Përmbaruesi Privat, me datë 13.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-02/2023 i datës 20.01.2023 dhe ankesa e palës ankuese e datës 16.01.2023 si të Pa Bazuara.

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr.135/22.

A r s y e t i m

Me datën 16.01.2023 pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat me pretendimin se përmbaruesi privat nuk ka dërguar asnjëherë urdhërin në adresë të saj, por urdhërin e ka dërguar në administratë të universitetit me ç'rast i është mohuar e drejta në prapësim dhe më është bërë tërheqja e mjeteve nga banka pa kurrfarë informimi për këtë rast.

Sipas palës ankuese është bërë manipulimi i nënshkrimit të saj, pasi avokati si palë kreditore këtu, ka keqpërdorur nënshkrimin dhe në bazë të një fature që asnjëherë nuk është pranuar nga pala ankuese ka inicuar këtë lëndë tek përmbaruesi.

Pasi ka kuptuar rastin pala ankuese ka kërkuar sqarim nga administrata e universitetit dhe nga përfaqësuesi ligjor i UP-së, është informuar që një avokat është thirrur në emrin e ankueses, mirëpo gjykata ka nxjerrë aktvendim duke konsideruar të tërhequr çfarëdo padie në emër të palës ankuese dhe kjo pasi nuk është sjellur autorizim i noterizuar sikurse është kërkuar nga gjykata dhe ky vendim mban shifrën C.nr.1490/20 dt.24.06.2022.

Përmbaruesi sipas palës ankuese i ka mohuar të drejtën në prapësim dhe ankesë duke mos i dorëzuar fare shkresat për këtë lëndë, por ka bërë tërheqjen në bankë në shumën prej 353.40 euro, për të cilën ka marrë njoftuar nga banka.

Me propozim për komisionin që përmbaruesi të mbahet përgjegjës dhe të kthehen mjetet e marrura pa të drejtë.

Me datën 20.01.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, në deklaratën e tij ka deklaruar se propozimi në kërre rast është parashtruar në pajtim me dispozitat e LPP-së, konform nenit 38 duke cekur të gjitha të dhënat dhe për bazë ka pasur faturën si dokument i besueshëm, që kjo faturë është faturë për shërbimet e dt.21.06.2022 e cila bazuar në Ligjin mbi avokatinë është dokument i përmbarueshëm sipas nenit 21.

Si dëshmi për dërgimin e faturës ka prezentuar e-mailin e dt.21.06.2022 në ora 03 e 49 minuta në adresën zyrtare të palës ankuese, dërgim ky i vlefshëm sipas dispozitave të nenit 103.2 të LPK-së.

Si provë tjetër për dërgimin e faturës ka prezentuar dërgesën me rekomandë të postës së Kosovës, të dt.12.07.2022.

Mbi këto është bërë lejimi sipas urdhërit P.nr.35/22, dt.15.08.2022.

Përmbaruesi ka deklaruar se bazuar në numrin e lëndës C.nr.1490/20 dt.21.06.2022, fatura është konsideruar dokument i përmbarueshëm bazuar në nenin 40 të LPP-së. Si organ i shkallës e parë ka miratuar urdhërin duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të LPP-së. Në momentin e lejimit përmbaruesi ka pasur vetëm faturën dhe nuk ka pasur ndonjë shkresë tjetër, provë apo autorizim, për të cilat pala ankuese është ankuar dhe përmbaruesi nuk ka tagër që të shqyrtuar ato, sepse janë objekt shqyrtimi në procedurën kontestimore.

Sa i përket pretendimit të palës ankuese lidhur me dorëzimin e urdhërit, përmbaruesi deklaron se ka provuar dërgimin e shkresave tek debitori, bazuar në dispozitat e LPK-së, duke e dërguar në adresën si në propozim në rr...

Tentimi është bërë në adresën _____ në Administratën Qendrore _____ dhe nga konstatimi i postës është ardhur se pala refuzon, pa arsytim. Sipas kësaj dorëzimi është bërë në harmoni me dispozitat e nenit 112 të LPK-së.

Përpos kësaj me qëllimin më të mirë është përsëritur edhe njëherë dërgesën në vendin e punës së debitorit dhe përsëri nga konstatimi i postës i dt.07.10.2022 është refuzuar me arsytim të dërgohen në adresë të shtëpisë.

Në përgjigje përmbaruesi deklaron se ka siguruar në ndërkohë edhe emaila të zyrtarit të universitetit si dhe disa vendime të gjykatës ku janë refuzuar prapësimet në këso raste si dhe

autorizimin e nënshkaur nga stafi përfshirë edhe këtu debitoren që ka autorizuar avokatin për ndërmarrjen e veprimeve .

Pasi urdhëri është bërë i plotëfuqishëm , përmbaruesi deklaron se ka marrë veprimet përmbarimore dhe se për çfarëdo lëshimi pala ka pasur të drejtën e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, me propozim për komisionin që të Refuzohet raporti përfundimtar i ministrisë dhe të Anulohet vendimi i komisionit disiplinor DPL.30/2022 dt.22.12.2022.

Në seancën dëgjimore palët kanë mbetur sikurse në kërkesat e tyre të mëhershme,ku pala ankuese ka deklaruar se nuk ka autorizuar avokatin këtu kreditorin për përfaqësim,mirëpo pas pyetjeve të anëtarëve të komisionit,e njehta deklaron se nënshkrimi në atë autorizim është i palës ankuese,por të njejtin e ka bërë pasi i njejtin i është ofruar për nënshkrim nga kolegu i punës,por nuk e ka lexuar fare përmbajtjen e atij nënshkrimi.

Përmbaruesi ka deklaruar se faturq është burim i autorizimit të datës 18.11.2019,por përmbarimi është lejuar ne bazë të faturës që sipas ligjit mbi avokatinë është dokument i besueshëm e që për përmbaruesin privat me rëndësi është që të jetë dokumenti i besueshëm sikurse parashihet me nenin 29 të LPP-së.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Këtë konstatim komisioni e bazon në faktin se përmbaruesi ka vepruar duke u bazuar në dokumentin e besueshëm faturën e kreditorit,e cila parashihet si dokument i besueshëm dhe bazë për inicim të procedurës përmbarimore,pastaj duke u bazuar ne shkresat e lëndës lidhur me ekspedimin e urdhërit,komunikimeve përmes postës elektronike në mes vetë palëve dhe deklarimet e vetë palës ankuese që ka nënshkruar autorizimin për këtu kreditorin por pa e ditur për tekstin e atij autorizimi

Komisioni ka trajtuar të gjitha provat dhe deklarimet e palëve dhe bazuar në ato vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.02/2023 datë 13.04.2023

Kryesuese e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.